



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 22.05.2018, ora 10:40

**Drejton mbledhjen:**

**Petrit Vasili – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 30.04.2018, 07.05.2018 dhe 09.05.2018.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 22 maj – 8 qershor 2018.

**Marrin pjesë:**

Petrit Vasili, Elisa Spiropali, Bardh Spahia, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Adelina Rista, Arben Kamami, Edlira Bode, Roland Xhelilaj, Floida Kërpaçi, Nuri Belba, Grida Shqina, Halim Kosova, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj, Nora Malaj, Vilma Bello si dhe deputetë të tjerë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

**Mungojnë:**

Vangjel Tavo, Flamur Golemi dhe Almira Xhembulla.

## HAPET MBLEDHJA

**Petrit Vasili** – Meqenëse u plotësua kuorumi, hapim mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë për ditën e sotme.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 30.04.2018, 07.05.2018, 09.05.2018 dhe miratimin e kalendarit të punës për periudhën 22 maj – 8 qershor, ku, në radhë të parë, është vendosur shqyrtimi i projektligjit “Për nxitjen e punësimit” për ditën e nesërme.

Në pjesën tjetër, meqenëse hapësira e komisionit e lejon, janë parashikuar edhe disa dëgjesa për disa ditë ndërkombëtare, si: Dita Ndërkombëtare e Luftës kundër Duhanit dhe Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, që do ta zhvillojmë në datën 30, sepse volit më mirë dhe është përpara seancës plenare të datës 31 (nuk mund të bëhet as të premtën), kjo dëgjese vjen sipas kërkesave të ardhura nga Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë dhe shqetësimet e veçanta në internet për sa u takon fëmijëve.

Për sa i takon projektligjit në fjalë, të mërkurën do të kemi shqyrtimin në parim duke u dhënë mundësinë të gjitha komisioneve për dhënie mendimi të kryejnë punën e tyre. Më vonë kemi një seancë dëgjimore me një nga shoqatat e Unionit të Ekspertëve Mjedisorë dhe shoqatës “MENV Group” lidhur me efektet në shëndet të disa veprave të caktuara që kanë pasur të tilla impakte të forta mjedisore, që ndikojnë edhe në shëndetin e njeriut. Ky propozim u ka ardhur të gjithë anëtarëve të komisionit.

Meqenëse tani duhet të jetë momenti i miratimit, në qoftë se ka komente, ndryshime apo ndërhyrje nga deputetët, jeni të mirëpritur t’i bëni.

Po, zoti Spahia.

**Bardh Spahia** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se ky komision duhet të marrë në shqyrtim dhe të diskutojë sot për çështjen më të rëndësishme, që i shqetëson sot qytetarët shqiptarë dhe mbarë opinionin publik, atë të drogës dhe të përfshirjes në trafikun e saj të krerëve më të lartë të qeverisë konkretisht, siç u pa në ditët e fundit, të ministrit të Brendshëm, për të cilin u faktua, tashmë në mbrojtje, madje prej disa kohësh se vëllai i tij, përveçse i dënuar nga një gjykatë italiane pas një operacioni ndërkombëtar të zhvilluar nga DEA amerikane dhe policia italiane, kishte vite që jo vetëm i shmangej drejtësisë italiane, por e vazhdonte aktivitetin, tashmë të vërtetuar, i patrazuar dhe nën mbrojtjen e vëllait të tij, ministër të Brendshëm, zotit Fatmir Xhafaj.

Unë nuk mendoj se sot ka ndonjë gjë më të rëndësishme për parlamentin shqiptar, për komisionet e tij, për të diskutuar, përveç çështjes së drogës dhe të implikimit të shtetit dhe qeverisë shqiptare, krerëve më të lartë të saj, në mbrojtjen dhe stimulimin e këtij trafikui.

Dua të them se me keqardhje kam konstatuar unë, ashtu si i gjithë opinioni publik, një përpjekje të vazhdueshme gjatë gjithë këtyre ditëve, pothuajse dy javëve, të strukturave të shtetit, të Kryeministrit, të ministrit Xhafaj, por edhe të komisioneve parlamentare, për të mbrojtur, për të mbuluar apo edhe për ta evituar si diskutim.

E pamë këtë në komisionet e tjera, në Komisionin e Ekonomisë, si dhe dje në Komisionin e Ligjeve, i cili duhet të ishte simboli i luftës kundër krimit dhe trafikut, i cili duhet të ishte në frontin e parë në këtë luftë, por e pamë tek e mbronte, tek e stimulonte krimin dhe trafikun.

Unë nuk mendoj se edhe Komisioni i Shëndetësisë duhet të bjerë në atë nivel, madje unë mendoja se duhet të shpreheshim të gjithë njëzëri kundër fenomenit “drogë”, aq më tepër kundër trafikut dhe përfshirjes së strukturave më të larta shtetërore: të ministrave, të Kryeministrit në të.

Të them të drejtën më zë trishtimi teksa i shoh shumë prej kolegëve të maxhorancës të bëhen mbrojtje e së keqes, mbrojtje e krimit. Pyetja që më lind është: a ju vret ndërgjegjja? Çfarë do t’u themi brezave të rinj? Çfarë do t’u thoni fëmijëve kur t’ju pyesin se cili ishte qëndrimi që mbajtët ndaj këtij fenomeni, tejet negativ për shoqërinë shqiptare?

Unë besoj, dhe këtë e kam për kolegët e maxhorancës, se edhe socialistët që ju kanë votuar, që ju kanë dhënë votën, nuk jua dhanë votën për të mbrojtur trafikun e drogës; nuk jua dhanë votën për ta mbushur Shqipërinë dhe për ta kthyer në hambarin e drogës së Europës; nuk jua dhanë votën për ta kthyer Shqipërinë në Kolumbinë e Europës, përkundrazi, jua dhanë votën për ta luftuar këtë fenomen.

Ju merrni në mbrojtje ministrin tuaj, kokë, tashmë e faktuar, e trafikut të drogës, dhe sulmoni opozitën, e cila ka pothuajse dy javë që ka faktuar tashmë përfshirjen e ministrit Xhafaj në trafikun e drogës dhe në mbrojtjen e vëllait të tij trafikant. Sot Fatmir Xhafaj duhej të ishte shkarkuar nga detyra dhe vëllai i tij duhej të ishte i arrestuar dhe i hetuar këtu në Shqipëri.

Kemi një pyetje: pse u largua me urgjencë Agron Xhafaj, pa dijeninë e askujt? U largua pikërisht për ta hequr nga drejtësia, për ta larguar atë dhe për t’u marrë pastaj direkt vëllai i tij, ministër, por edhe Kryeministri, me mbulimin e fakteve, me mbulimin medietik të çështjes së përfshirjes së vëllait të tij direkt në trafikun e drogës. Madje unë mendoj se sot duhet të ishte në hetim e gjithë pasuria e vëllezërve Xhafaj, e familjes Xhafaj. Sot Fatmir Xhafaj duhet të

ishte subjekt direkt i ligjit të antimafias, ai vetë po e po, por edhe e gjithë pasuria e familjes së tij.

Besoj se shqiptarët e kanë të qartë tashmë, madje, siç u pa para pak ditëve, e pranoi edhe vetë ministri Xhafaj se vëllai i tij ishte jo vetëm i dënuar, por edhe i përfshirë së fundi dhe vazhdonte i pacenuar trafikun e drogës në qytetin e Vlorës, me shtrirje në të gjithë Shqipërinë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elisa Spiropali** – Për procedurë.

**Petrit Vasili** – Ta mbarojë dhe jua jap fjalën.

*(Deputetja Spiropali flet pa mikrofon.)*

**Bardh Spahia** – Po kërkoj pikërisht ta fusim në kalendar këtë çështje.

**Elisa Spiropali** – ...ç' kusur kemi t'ju dëgjojmë juve tani?

Të lutem, zoti kryetar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bardh Spahia** – Ju lutem, dëgjoni, se nuk është...

*(Deputetja Spiropali ndërhyr pa mikrofon.)*

**Petrit Vasili** – Ta mbarojë zotëria fjalën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bardh Spahia** – Unë ju...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe një herë, unë besoj se...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elisa Spiropali** – Dukeni sikur e keni pirë të tërën!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bardh Spahia** – Ju lutem!

Unë besoj se sot...

*(Debat në sallë)*

Zotërinj kolegë, edhe një herë, Fatmir Xhafaj, po e përsëris, duhet të ishte sot i dorëhequr, vëllai i tij i arrestuar dhe nën hetim...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Familja dhe pasuria e tij duhet të ishin subjekte të ligjit të antimafias. Por ju zgjidhni të merreni me opozitën dhe me ndalimin e fjalës së opozitës.

E keni gabim!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po jua them edhe një herë: e keni gabim!

Opinionimi publik pret nga ju dhe nga qeveria pikërisht përgjigjen e asaj pyetjeje që, me të drejtë, e ngriti një gazetare e re, e cila bëri një pyetje sa të thjeshtë, aq edhe empirike: “Si ka mundësi që dy ministra të Brendshëm, njëri pas tjetrit, dalin të implikuar direkt në trafik droge, ku njëri është sot në arrest shtëpie, tjetri i hetuar për implikimin direkt të vëllait të tij, me mbrojtjen e tij në trafik ndërkombëtar droge”? Kjo pyetje është e thjeshtë.

Pyetja tjetër ishte: “Si ka mundësi që Partia Socialiste nuk e gjen dot një ministër për ministrinë më të rëndësishme të saj, një person...”

**Elisa Spiropali** – Përmbledhe tani, se kemi edhe punë të tjera!

**Bardh Spahia** – ...të pa implikuar në çështjet e drogës”?

Edhe një herë, do të ishte në nderin tuaj të distancoheshit qartazi nga implikimi në trafikun e drogës të drejtuesve më të lartë të qeverisë suaj; t’ua thoni qytetarëve shqiptarë se jeni kundër këtij fenomeni, se distancoheni haptazi nga implikimi i kolegëve tuaj ministra, por edhe të Kryeministrit, në trafik droge, në një prej fenomeneve më shqetësuese sot për sot për shoqërinë shqiptare, për Shqipërinë; një fenomen, të cilin do ta vuajnë rëndë brezat e ardhshëm dhe për këtë do të mbajë përgjegjësi gjithsecili prej nesh, por kryesisht ju që e stimuluat apo, në rastin më të mirë, nuk patët kurajën të ngrini zërin!

Edhe një herë, faleminderit!

**Petrit Vasili** – Po, zonja Spiropali.

**Elisa Spiropali** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit kolegëve të opozitës, që na bënë edhe ne pjesë të këtij teatri shëtitës nëpër dyert e komisioneve parlamentare!

Ajo që unë dua të them është se këtu, në këtë tryezë dhe në këtë komision, diskutohen çështje që kanë lidhje me punën, me çështjet sociale dhe shëndetësinë.

**Bardh Spahia** – Droga nuk hyn?!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elisa Spiropali** – Në rast se...

**Bardh Spahia** – Droga nuk ka lidhje, Elisa?!

**Elisa Spiropali** – ...ju keni ardhur për të diskutuar për çështjen e shumëpërfolur të audios së prodhuar në bodrumet tuaja...

**Bardh Spahia** – Të drogës.

**Elisa Spiropali** – ...po jua them, edhe një herë, për sa u përket akuzave të drejtësisë, ne nuk jemi si ju, por do të presim deri në fund fjalën e prokurorisë, së cilës ju nuk i besoni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rast se nuk i besoni asaj, le ta çojnë në një agjenci të specializuar ndërkombëtare dhe të marrin përgjigjen.

**Bardh Spahia** – E ka pranuar ministri juaj përfshirjen e vëllait të tij!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elisa Spiropali** – Në rast se...

**Bardh Spahia** – E ka pranuar ministri.

**Elisa Spiropali** – Bardhi, tregohu aq xhentil sa u treguam ne me atë, se nuk po e them poezinë tuaj të gjatë!

Tani, për sa u përket akuzave të drejtësisë, ne kemi durimin...

**Bardh Spahia** – Janë çështje të rëndësishme, moj!

**Elisa Spiropali** – Patjetër! Ndaj, të presim deri në fund përgjigjet e prokurorisë, një më një, për të gjithë pjesët e asaj audioje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bardh Spahia** – Të presim siç pritëm për Saimir Tahirin, katër vjet?!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elisa Spiropali** – Për sa u përket akuzave tuaja, pa diskutim që do të përgjigjemi.

*(Deputeti Spaho ndërhyr pa mikrofon.)*

Përgjigjen e keni marrë, zgjedhje pas zgjedhjesh, aty e keni! Shkoni përballuni, të shikojmë sa besim krijoni në publik!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bardh Spahia** – Të presim si për Saimir Tahirin?!

**Elisa Spiropali** – Është...

**Bardh Spahia** – Tre vjet flisnim për trafikun e Saimir Tahirit!

**Elisa Spiropali** – Është shumë për të qeshur kur dy burra mundohen të mbysin zërin e një gruaje!

*(Deputeti Spaho ndërhyr pa mikrofon.)*

Është shumë për të qeshur, zoti Spaho!

Tani, më lejoni ta mbaroj, pastaj vazhdoni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e mbysni dot zërin ju, duke u çjerrë, zoti Spaho!

**Edmond Spaho** – Deri tani nuk keni qenë në gjendje ta mbysni, sepse i ka hedhur rrënjët fort...

*(Deputeti Spaho flet pa mikrofon.)*

**Elisa Spiropali** – Ju jeni brenda!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ilir Pendavinji** – Zoti kryetar.

**Elisa Spiropali** – Jo, duhet ta mbaroj, të lutem!

**Ilir Pendavinji** – Patjetër.

**Petrit Vasili** – Po, zonja Spiropali.

**Elisa Spiropali** – E dyta, është, në fakt, e pakuptimtë dhe e trishtueshme se si opozita zgjedh të zhytet në gjirizet e krimit për të nxjerrë andej...

*(Deputeti Spaho ndërhyr pa mikrofon.)*

...gurë, për t'ia vënë përpara Shqipërisë në kilometrat e saj të fundit drejt Bashkimit Europian.

**Bardh Spahia** – Keni dy ministra të përfshirë, Elisa!

**Elisa Spiropali** – Kjo është zgjedhja juaj!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të më lejoni të mbaroj?

*(Deputeti Spaho ndërhyr pa mikrofon.)*

**Ilir Pendavinji** – Kjo punë mori erë, u pa!

**Elisa Spiropali** – A ka mundësi të vazhdoj?

Kur ta keni ju radhën, zoti Spaho, se do ta keni edhe ju radhën në teatrin shëtitës, merreni fjalën dhe vazhdoni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Petrit Vasili** – Zoti Bumçi, ju lutem!

**Elisa Spiropali** – Gurët që keni nxjerrë, sigurisht do t'ju bien kokës, nuk diskutohet, sepse Shqipëria do të bëhet me apo pa ju!

**Bardh Spahia** – Siç na ranë me Saimir Tahirin!

**Elisa Spiropali** – Për sa i përket prokurorisë dhe Ministrisë së Brendshme, janë dy institucione, të cilat ju më së shumti i keni sulmuar dhe nuk keni përtuar të hidhni mbi to të gjithë baltën dhe llumin e mundshëm. Ato janë institucione shumë të rëndësishme, të cilave tani u keni bërë një puç, i cili sigurisht, nuk është më me armë si në vitin '98, por është i sajuar, i stisur dhe i dëmshëm. Duhet të përgjigjet dikush për këtë.

Ata që janë në video.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kush e ka sajuar atë, do të përgjigjet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E fundit, as ishte parë, as ishte dëgjuar, as ishte pritur që ju të PD-së të kaloni nga partia e babë Saliut te partia e babale Veliut.

Ne presim që ju të ngriheni në nivelin e përgjegjësive tuaja dhe të vini këtu në komision dhe të diskutoni për çështjet, të shkoni në seancë plenare dhe të ngrini zërin.

Ne nuk presim që ju të bëheni pengesa kryesore e Shqipërisë. Ju jeni bërë jo vetëm turp i Shqipërisë, por jeni bërë turp ndërkombëtar. Të jeni të sigurt që edhe pas 100 vjetësh do t'ju shkruhet emri në librat e historisë, se nuk ishte parë kurrë që deputetët e opozitës të merren me sajimin e një videoje me fundin e kazanit të krimit në Shqipëri. Ne do të presim prokurorinë. Shkoni dhe dëshmoni! Të dëshmojnë të gjithë ata, që janë të përfshirë në këtë çështje!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mos sulmoni prokuroren dhe Ministrinë e Brendshme! Lërimi të bëjnë detyrën, të cilën po e bëjnë me përgjegjshmërinë më të lartë! Këtë nuk po e thotë qeveria, por e thonë partnerët tanë ndërkombëtarë.

Të gjitha akuzat tuaja janë zhbërë, që nga akuza e parë se nuk është ekstraduar, deri te akuza e dytë se ka infiltruar një nen, i cili e mbron me ligj nga ekstradimi. Ja ku deklaroi edhe BE-ja se ai ligj është brenda të gjitha standardeve të Konventës së Ekstradimit.

Edhe e treta do t'ju zhbëhet. Prisni deri në fund ekspertizën e agjencive të specializuara dhe të prokurorisë! Mos kini frikë nga prokuroria! Siç duket këtu fillon dhe këtu mbaron problemi juaj.

**Petrit Vasili** – Fjalën e ka zoti Bumçi!

Ka vetëm një gjë, meqenëse u shkëmbye një debat politik, që të jemi të sigurtë me qytetarët, verifikimi i audiopërgjimit është bërë nga Kryeministri dhe ai ka thënë se ai nuk është autentik.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, ai e ka thënë dhe e ka marrë përsipër vetë.

**Elisa Spiropali** - Nuk ju lejoj.

**Petrit Vasili** – Nuk marr leje nga ty unë.

Këtë ai e ka thënë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nëse ka dy shqipe, një për ju dhe një për shqiptarët...

**Elisa Spiropali** – Kryeministri ka deklaruar, se pa diskutim për qartësimin e ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ashtu do të dalë. Prisni se do t'ia dëgjoni zërin kësaj historie!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një qartësim politik, ka të drejtë ta bëjë. Prokuroria do të bëjë qartësimin për përgjegjësitë ligjore.

**Petrit Vasili** –Mbaruat?

Vazhdoni, Aldo!

**Aldo Bumçi** – Zoti kryetar,

Ju propozuat që në rend të ditës të jenë:

- Në kuadër të Ditës Botërore të Luftës Kundër Duhanit, një seancë dëgjimore publike me institucionet përkatëse për zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

- Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, një seancë dëgjimore publike për sensibilizimin e opinionit publik për të mbrojtur fëmijët nga dhuna.

Unë mendoj se ky komision më shumë se çdo komision tjetër duhet ta ketë çdo ditë Ditë Kombëtare të Drogës. Shqipëria prej disa vitesh ka çdo ditë vetëm një çështje: drogën, zhytjen e vendit në drogë.

Në raportet e vitit 2017 të Zyrës së UN-së për drogën dhe krimin, është publikuar, se 2,5% e popullsisë shqiptare rezulton të jetë përdorues kokaine. Jemi vendi i parë në botë për përdoruesit e kokainës, të ndjekur të ndjekur nga SHBA, me 2,3% të popullsisë. Vendi më i pasur i botës ka 2,3% të popullsisë të varur nga kokaina, ndërsa Shqipëria ka 2,5% të popullsisë.

Shpërndarja e hashashit është kthyer masive në shkollat 9-vjeçare dhe në gjimnaze.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Raporti i BB-së i vitit 2017, i gjetur lehtësisht. *UN Office Report on Drugs and Crime* thotë: Shqipëria ka 2,5% e popullsisë shqiptare të varur nga kokaina dhe e dyta, pas nesh, vjen SHBA me 2,3% të popullsisë.

Sa jetë njerëzore janë shkatërruar? Sa familje janë shkatërruar nga varësia nga droga? Sa të rinj shqiptarë kanë përfunduar burgjeve të Shqipërisë dhe të Europës, sepse këta e kthyen drogën në model jete, në politikë kombëtare?

Sa të rinj shqiptarë kanë vdekur dhe sa të tjerë do të vdesin nga hesapet e drogës? Këto janë jetë njerëzish, janë një plagë e hapur, e cila nuk e dimë se kur do të mbyllet, që këta ia shkaktuan këtij populli?

Nëse e llogarisim me jetë njerëzish, ka edhe llogari të tjera. Kemi Shoqatën e Prodhuesve Shqiptarë, Shoqatën e Eksportuesve, të cilat flasin.

Është edhe BSH-ja, e cila flet për humbje masive në ekonominë shqiptare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sipas BSH-së në 4 muajt e parë ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Pse bëni zhurmuesin? Zhurmuesin e kujt po bëni? Keni frikë nga këto të dhëna?

Me 35% është rritur sasia e eurove në ekonominë shqiptare në 4 muajt e parë të këtij viti. Në vlerë absolute, sipas BSH-së, janë futur në ekonominë shqiptare rreth 500 milionë euro vetëm në 4 muajt e parë të këtij viti. Këto euro nuk vijnë nga rritja e të ardhurave të emigrantëve, të cilat janë në ulje, as nga rritja e investimeve të huaja në Shqipëri, sepse nuk ka investime të reja, të huaja në Shqipëri, por vijnë nga lekët e drogës dhe të hashashit, nga shitja e tyre.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Këto euro nuk vijnë nëpërmjet kanaleve tregtare. Çfarë ka ndodhur nga narkoeurot? Po dëmtohet shtylla kurrizore e ekonomisë shqiptare.

Sipas Shoqatave të Prodhuesve Shqiptarë, sipas Shoqatës së Eksportuesve Shqiptarë, të cilët i kanë dërguar 2 herë qeverisë shqiptare, Kuvendit të Shqipërisë dhe BSH-së arsyen e zhvlerësimit dramatik të euros. Kjo ka ardhur nga eurot që kanë ardhur nga droga dhe ka sjellë një dëm të jashtëzakonshëm në industrinë prodhuese dhe të eksportuesit shqiptarë.

Sipas llogaritjeve të Shoqatës së Eksportuesve Shqiptarë humbjet e eksportuesve shqiptarë janë 120 milionë euro. Këto janë llogaritur nga Shoqata e Eksportuesve Shqiptarë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sipas Rregullores së Kuvendit çdo deputet ka të drejtën e fjalës. Këta janë deputetët që mbrojnë narkoeurot, drogën në Shqipëri dhe nuk na lënë as të flasim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A mund të heshtni, ju lutem?

Sipas llogaritjeve, më të goditurit janë fermerët shqiptarë. Prodhimet bujqësore shqiptare që eksportohen, janë më të goditurat nga zhvlerësimi i euros për shkak të narkoeurove, për shkak të eurove të drogës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dje, në një konferencë për shtyp Shoqata e Bimëve Mjekësore e cila eksporton rreth 45 milionë euro në vit ...

**Klodiana Spahiu** – Si sekretare e komisionit, ju kërkoj të bëni detyrën!

Të vijojmë në bazë të programit që na keni sjellë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Aldo Bumçi** – ... dhe ka punësuar 90 mijë qytetarë shqiptarë në zonat rurale, zonat më të varfra të Shqipërisë, deklaroi se po shkon drejt falimentimit për shkak të zhvlerësimit të euros.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka humbje masive në sektorin fason. Vitin e kaluar ky sektor pati 27 milionë euro humbje për shkak të zhvlerësimit të euros. Këtë vit ka 30 milionë euro humbje në prodhimin e veshjeve dhe të këpucëve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zhvlerësimi i depozitave të shtetasve shqiptarë. 52% e depozitave të shtetasve shqiptarë janë në euro. Janë 3,7 miliardë euro depozita. Vetëm në 4 muajt e parë të këtij viti, kjo sasi ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

... eurosh është zhvlerësuar me 150 milionë euro.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk ju interesojnë të ardhurat e qytetarëve shqiptarë? Ju keni depozita, qytetarët shqiptarë kanë depozita, sipërmarrësit po ashtu. Janë zhvlerësuar 150 milionë euro për shkak të narkoeurove.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Remitancat, të ardhurat që familjet shqiptare marrin nga fëmijët e tyre që punojnë në Perëndim, janë 600 milionë euro. Për çdo 100 euro që një shqiptar që punon në Greqi ia çon familjes së tij...

**Elisa Spiropali** – Zoti kryetar,

Po e merrni peng këtë komision.

**Aldo Bumçi** – Për shkak të zhvlerësimit të euros ato 100 euro nuk kanë më vlerën 140 mijë apo 136 mijë lekëve që qenë vjet, por kanë vlerën 126 mijë lekë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Çfarë nuk është e vërtetë këtu?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

... të të ardhurave nga emigrantët për shkak të narkoeurove.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

... si pasojë e zhvlerësimit masiv të euros për shkak të drogës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sot janë goditur prodhuesit dhe eksportuesit shqiptarë, fasonët, prodhuesit e tullave dhe të çimentos.

**Petrit Vasili** – Përfundojeni, zoti Bumçi!

**Aldo Bumçi** – Po e përfundoj.

Shqipëria e zhytur në krim dhe në drogë është vepër e Edi Ramës, e një politike kombëtare të Edi Ramës për ta zhytur Shqipërinë në krim dhe në drogë. Saimir Tahiri dhe Fatmir Xhafaj nuk janë asgjë tjetër, veçse zgjedhje të Edi Ramës për të vazhduar politikën e tij për ta zhytur Shqipërinë në krim dhe në drogë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ky stan këtë bulmet ka: Saimir Tahirin dhe Fatmir Xhafajn me të vëllain të dënuar për trafik ndërkombëtar droge, i dënuar nga Gjykata e Lartë Italiane me 7 vjet e 2 muaj burg me një hetim, ku është përfshirë DEA.

Ky njeri, në një Shqipëri të mbushur me drogë, ku Saimir Tahiri është në arrest shtëpie, bëhet ministër i Brendshëm. Ku mund të ndodhë kjo, përveçse në një vend, që ka për Kryeministër Edi Ramën? Në asnjë vend tjetër nuk mund të ndodhë kjo, përveçse në këtë vend.

Ky stan këtë bulmet ka. Edhe ai që do të vijë pas tyre për sa kohë të jetë Edi Rama, do të jetë përsëri si këta, sepse Edi Rama di vetëm një gjë: narkoeurot që vijnë nga droga, të cilat po e godasin dhe po e shkatërrojnë ekonominë shqiptare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem!

Në fund fare, janë ligjet shqiptare të shkelura në dritën e diellit, nga ai, si kryetar i Komisionit të Ligjeve. Këtu po regjistrohet gjithçka po themi dhe zbardhet procesverbali. Po kështu ka ndodhur edhe në Komisionin e Ligjeve, ku nuk do të gjeni në mbledhjet e atij komisioni, asnjë nen, asnjë fjalë, asnjë fjali ku të jetë diskutuar çështja e ligjit për ekstradimin. Atë e futi Fatmir Xhafaj për të mbrojtur vëllain e tij.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elisa Spiropali** – E morët përgjigjen për atë nen të famshëm dhe u diskretituat.

**Aldo Bumçi** – Marrëveshjet e ekstradimit me SHBA-në, me Britaninë e Madhe dhe me Italinë janë bërë nul, janë bërë zero. Sot nuk mund të ekstradohet askush, as në SHBA, as në Britaninë e Madhe dhe as në Itali...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elisa Spiropali** – Unë i kërkoj kryetarit të komisionit të vërë rregull dhe në bazë të Rregullores të vijojmë me kalendarin e ditës, se për këtë kemi ardhur sot këtu.

**Aldo Bumçi** – E dyta, ligji antimafias thotë se kur je në hetim, ka sekuestro preventive të të ardhurave nga droga.

**Elisa Spiropali** – Aldo, i lodhe edhe të tutë.

**Aldo Bumçi** – Po kur dënohesh nga Gjykata e Lartë Italiane, a duhet të ketë konfiskim të të ardhurave nga droga?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vetë ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj tha: teorikisht unë jam subjekt i këtij ligji, por jo praktikisht. Jo, sepse është ministër i Brendshëm.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

... Sepse Prokurore e Përgjithshme është një zonjë e emëruar me 69 vota të këtyre. Kush do t'i hetojë? Kryeministri që i dha udhëzime hetimit dhe tha se e ka bërë një hetim për regjistrimin, i cili nuk doli autentik. Pra, ia dha udhëzimin Prokurores së Përgjithshme të emëruar me 69 vota.

Ka vetëm një zgjidhje: largimi i Edi Ramës, sepse ky stan këtë bulmet ka: drogë dhe asgjë tjetër.

**Petrit Vasili** – Urdhëroni, zonjë!

**Klodiana Spahiu** – Ju lutem, zoti Vasili!

Meqenëse ju jeni kryetar i këtij komisioni, është e vërtetë që ju përfaqësoni opozitën e bashkuar, por ju duhet të dini të ruani pozicionin tuaj në këtë komision.

Ju lutem, a mund të mbarojë tragjikomedia e opozitës, sepse janë katandisur si mos më keq?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem zoti Vasili, a mund të rikthehemi në normalitet në këtë komision dhe të diskutojmë kalendarin? Kemi ardhur sot për respekt të atij kalendari që ju na sollët. Do të ishte mirë që opozita shqiptare të ishte pjesë e komisioneve dhe të ketë fjalën në parlament.

Nëse ju do ta ktheni këtë në një debat televiziv të opozitës shqiptare, kjo nuk ndihmon askënd nga ju, por mbi të gjitha ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zoti Spaho,

Megjithë respektin që kam për ju, kjo që po bëni, nuk ju vlen. A e kuptoni se çfarë po bëni? Ju po degjeroni veten tuaj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zoti Spaho!

Ju duhet të jeni lider si opozitë për të bërë punën tuaj, për të qenë përballë qeverisë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk ikën Fatmir Xhafaj, se thua ti, zoti Spaho.

Ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sepse ne jemi të vendosur...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

... Ju lutem, sepse ne jemi të vendosur...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Spaho, keni qenë në 10 studio televizive dhe i keni bërë këto debate. Ju lutem na lini të bëjmë punën në komision!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, zoti Spaho, na lini të bëjmë punën!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E keni thënë, e keni denoncuar dhe e keni çuar në prokurori. Lëreni prokurorinë të bëjë punën e saj dhe ju bëni punën tuaj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Bëni punën tuaj në komisione, sepse qytetarët ju kanë votuar për të bërë punën tuaj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Spaho, përrallat po dalin në çdo televizor dhe ju nuk e dini si do t'i shkojë fundi kësaj pune. Kështu që ju lutem, me gjithë respektin e madh që kam për opozitën dhe për zonjat e këtij komisioni, rikthehuni në komision, hajdeni bëni punën që ju takon, që jeni votuar dhe që paguheni nga qytetarët. Nuk ju takon të bëni....

**Bardhi Spahia** – Nuk jeni vetëm ju gazetarët, jemi edhe ne zëdhënës të prokurorisë...

**Klodiana Spahiu** – Bardhi, të lutem! A mund të bëhesh pjesë jona të vazhdojmë me kalendarin?

**Bardh Spahia** – Asgjë nuk ka më të rëndësishme sot, se sa nevoja urgjente e kësaj shoqërie për t'u shkëputur një herë e mirë nga droga.

**Klodiana Spahiu-** Nuk mund të degjenerohet institucioni i parlamentit.

**Bardh Spahia** – Shkëputuni nga droga. Thojuni qartë qytetarëve shqiptarë që jeni kundër drogës.

**Klodiana Spahiu** - O Bardhi, po si ka mundësi që bën kështu?!

**Bardh Spahia** – Shikoni zëdhënësit e prokurorisë, të cilët e pranojnë vetë.

**Klodiana Spahiu** – Edhe një herë, të nderuar kolegë, me shumë dashamirësi, nëse doni të vazhdoni mbledhjen e komisionit, ne do të rrimë bashkë me ju dhe do të bëjmë kalendarin, por, nëse dëshironi të vazhdoni me tragjikomedinë e radhës, atëherë na thoni, që edhe ne të bëjmë një punë tjetër dhe të rikthehemi kur të mbaroni ju.

Zoti Spaho, edhe një herë po ju bëj thirrje, shkoni në Komisionin e Ekonomisë, pasi jeni njeri i nderuar, të vijë zonjat në Komisionin e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, sepse kemi shumë gjëra për të diskutuar dhe i lëmë secilit institucion punën e tij.

Meqenëse ne jemi një institucion që respektohet nga qytetarët dhe secili prej nesh përfaqëson zërin e qytetarëve, ju lutem të bëjë secili punën e tij, sepse, kështu siç e kemi nisur ne, nuk do t'i çojmë gjërat përpara dhe fundi i kësaj do të jetë në negativitet të qytetarëve.

Ju e dini shumë mirë pse po e bëni këtë. Ju po e bëni që të mos ndodhë integrimi i Shqipërisë, ju e keni në kokën tuaj këtë, por kjo është në dëm të secilit prej qytetarëve.

**Bardh Spahia** – Ne nuk jemi Erion Veliaj, i cili sajoi letrën e famshme bashkë me Elvis Roshin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Klodiana Spahiu** – Mua më bëhet qejfi që u kujtua opozita të vijë në komisionin tonë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sepse ju nuk e doni. Kjo është e keqja e madhe.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ky është dënimi që do t'ju japin qytetarët, dënimi që do të merrni në vitin 2019 dhe në të gjitha vitet e ardhshme.

**Bardh Spahia** – Zonja Spahiu, ne nuk jemi Erion Veliaj, i cili sajoi shkresa bashkë me Elvis Roshin, që u dërgoi kancelarive ndërkombëtare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Petrit Vasili** – Zonja Metaliaj, fjala për ju.

**Lindita Metaliaj** – Faleminderit, kryetar!

Unë dua t'u bëj një pyetje deputetëve të maxhorancës. Unë e kuptoj shumë mirë hallin dhe zhurmën që doni të bëni, por ju lutem mos u bëni qesharakë me inteligjencën e shqiptarëve,

sepse provat dhe faktet tona janë kokëforta dhe flasin qartë. Në videot tona nuk ka mashtrime, ato janë më se autentike...

**Klodiana Spahiu** – Mos u merr me videot ti, moj zonjë, ç'punë ke ti me videot?! Hajde...

**Lindita Metaliaj** – Të lutem, mos bëj zhurmuesin. Kur t'ju jepet fjala mund ta mbroni Skenderbeun tuaj, narkoskenderbeun tuaj dhe gjithë bandën e tij qeverisëse.

Nuk ka se si të ketë normalitet në këtë komision, në çdo komision tjetër apo në seancat parlamentare...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, mos bëj zhurmuesin, sepse nuk ju ndërpreva. Shqipëria sot ndodhet në anormalitet dhe këtë nuk e them unë, por e thonë provat dhe faktet kokëforta, të cilat tregojnë implikimin e këtij ministri të Brendshëm dhe atij që ishte përpara, që bëjnë urën lidhëse midis shtetit dhe krimit. Ky është problem i madh. Nuk ka si të ketë normalitet pa dhënë dorëheqjen Fatmir Xhafaj dhe e gjithë banda e tij qeverisëse.

Për cilën çështje do të flasim? Për shëndetësinë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pse po bërtet? Kujt i bën presion ti? Nuk e hamë më presionin tuaj dhe nuk mund të intimidoni asnjëri.

Për çfarë e kemi komisionin?! Për punën, shëndetësinë dhe çështjet sociale. Kjo është temë e rendit të ditës, madje, duhet t'ju vijë turp para qytetarëve që ju kanë votuar dhe që paguheni nga lekët e tyre.

Normaliteti do të kthehet vetëm kur të japë dorëheqjen ministri juaj i Brendshëm, i cili shërben...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E vendosin faktet dhe provat kokëforta, që janë me zë dhe figurë, të cilat tregojnë implikimin e tij, në bashkëpunim me vëllanë e tij dhe të gjithë bandën tjetër qeverisëse.

Organi më i rëndësishëm për të vendosur rendin dhe sigurinë në vend ka rënë, sepse po bashkëpunon dhe po mbron trafikantët e drogës. Ai mbrojti me të gjitha format vëllanë e tij, trafikant droge. Çfarë bëri kur ishte kryetar i Komisionit të Ligjeve? Falsifikoi Kodin e Procedurës Penale për të mos kryer ekstradimin e të vëllait. Në momentin që po flasim, Ministria e Brendshme është organi që duhet të zbatonte ligjin antimafia, por nuk e zbaton dot, sepse ministri dhe familjarët e tij janë subjekt i ligjit antimafia. Prandaj vetingu duhet të fillojë

nga ministri Xhafaj, por nuk fillon dot, sepse është i implikuar deri në fyt. Normaliteti do të kthehet vetëm kur Xhafaj do të japë dorëheqjen.

Në datën 26 maj do ta shikoni nga qytetarët se çfarë do të bëni. Do të jenë qytetarët, të cilët do të japin drejtimin e duhur. Aty do të shikoni se sa ju vlen lëkura. T'ju vijë turp për moralin që tregoni përballë zgjedhësve tuaj. Ju nuk jeni votuar për të mbështetur krimin, por për ta luftuar krimin dhe për ta denoncuar bashkë me ne.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk po e bëni siç duhet. E keni me prova të pakontestueshme, me zë dhe me figurë. Faleminderit!

**Petrit Vasili** – Zonja Spiropali.

**Elisa Spiropali** – Më vjen keq ta them, por disa nga kolegët po flasin sikur kanë pirë gjysmën e asaj që është mbjellë në Lazarat. Ne kemi përgjegjësinë dhe durimin për t'i dëgjuar dhe ky është fakt, që po shihet nga të gjithë qytetarët, por që ne ta degradojmë debatin parlamentar nëpër komisione deri në këtë nivel, është e turpshme. Përfytyrojeni për një sekondë se si dukemi përpara kamerave, njerëz që çirren, njerëz që bërtasin sa kanë në kokë, që duan të kriminalizojnë qeverinë e këtij vendi, Ministrinë e Brendshme, prokurorinë, Shqipërinë dhe nuk kanë të ndalur në shejtan budallallëkun e tyre. E them edhe një herë dhe më vjen keq, por është e turpshme.

Unë kërkoj nga kryetari i këtij komisioni, që është zoti Vasili, ta drejtojë këtë komision me paanshmëri dhe t'i përmbahet rendit të ditës. Sot kemi ardhur të votojmë kalendarin. Këtu ka pika shumë të rëndësishme, të cilat ne duhet t'i diskutojmë me përgjegjshmëri.

Të enjten ka seancë plenare, ju, falë Zotit, keni miell, keni ujë, vishni çizme, nuk e di, por i keni të gjitha mjetet e mundshme për ta bërë atë seancë ashtu siç ju takon. Hajdeni bëjeni aty dhe, të paktën, uzurponi vetëm atë hapësirë parlamentare, por lejoni komisionet parlamentare të bëjnë punën e tyre. Hiqni dorë nga ky teatër, nga kjo sajesë, nga kjo montaturë, nga ky impostim dhe ky uzurpim i hapësirës publike. Jeni bërë të lodhshëm edhe për votuesit tuaj. Duhet ta kuptoni që çdo 4 vjet humbi nga 220 mijë vota, të cilat dhe ato nuk mund t'i kompensoni duke ngritur zërin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ato vota fitohen me vizion, fitohen me lidërsip, fitohen me vullnet, fitohen kur keni në krye një udhëheqës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Strazimiri, unë e çmoj shumë vlerësimin tuaj me çdo duartrokitje! *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, me thënë të drejtën jemi komision i mirë! Pse nuk vini këtu?!

Thirrja jonë për t'u bërë bashkë në këtë kohë mos t'ju duket si dobësi. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mirë e kemi! Hamzain mirë e keni?! Hamzai mirë është? Si e keni Babalen?! *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fatja i kishte marr masat, por mungonit ju për ta ndriçuar atë dasmë!

Puna është që të bëhemi bashkë këtë muaj. Në rast se nuk doni që së bashku ne të ecim përpara në këtë rrugë që kemi nisur, nga e cila më së shumti përfitoni ju, apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sepse qeveria do të monitorohet më shumë, kapituajt që do të negociohen do të kenë një vëmendje shumë më të madhe dhe përfitoni ju. Ju shpëtoni, edhe nga autoritarizmi ynë e të tjera gjëra, apo jo?! Çelja e negociatave do të thotë se ne do të monitorohemi.

Tani, të bëhemi seriozë dhe të kthehemi, nëse jo, të vazhdojë historia, ajo çështje është në prokurori, të hetohet deri në fund dhe kush ka përgjegjësi për këtë çështje, për këtë grusht shteti të organizuar kundër Ministrisë së Brendshme dhe prokurorisë, sepse e kishe merak...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër kur prokuroria sulmohet me gurë, disa njerëz kanë detyrë që të dalin përpara, zoti Bardhi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, keni sulmuar me gurë, me uji, keni hedhur shashka, keni hedhur tymues kur u zgjodh kryeprokurorja. Problemin e keni tek ajo. Më vjen keq t'ju them se ka mbështetjen shumë të madhe nga të gjitha palët dhe do të bëjë detyrën saj deri në fund.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju qëndroni si burra dhe si gra drejt dhe të shikojmë deri në fund si del kjo çështja e “Babales” suaj, i cili është kthyer në simbolin më të fortë të opozitarizmit. Ju lutem, mos e shani nëpër debate parlamentare, ai ju ka dhënë kauzën, as mos e shani në debate televizive, sepse ai ju ka dhënë kauzën më të madhe.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Klevis Balliu** - Edhe vetë po qesh, o Elisë!

**Elisa Spiropali** – Shyqyr që doli flamuri i “Babales”, të cilin e ngritët sipër. Duartrokitje zoti Strazimiri dhe jeni në rregull!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Petrit Vasili** – Urdhëroni, zoti Balliu!

**Klevis Balliu** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të akuzoni ju Partinë Demokratike, si e lidhur me krimin dhe me mafien, është njësoj si të thotë Hitleri racist. Së pari.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Së dyti, në qoftë se doni të diskutoni për rendin e ditës, i cili është...

**Adelina Rista** - Të lutem, zoti kryetar, për çfarë e mori fjalën, për procedurë apo për rendin e ditës?

**Petrit Vasili** – Siç e kanë marr të gjithë të tjerët.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Klevis Balliu** – A ka mundësi të mos flisni?!

**Petrit Vasili** – Zoti Balliu, nëse keni për të folur, vazhdoni flisni.

**Klevis Balliu** – Në qoftë se doni të flisni për rendin e ditës, absolutisht të gjitha ato problematika janë të rëndësishme. Nuk mund të ecet përpara pa zgjidhur çështjen më kryesore, që është droga dhe lidhjet e kësaj qeverie me narkotrafikantët.

Për videopërgjimin, që ju thoni se nuk është i vërtetë, në qoftë se nuk është i vërtetë, pse vëllai iku në Itali të bënte burgun?!

Së dyti, në qoftë se ju paskeni këtë agjencinë dhe e paskeni zgjidhur, deklarojeni se cila është kjo agjenci?

**Elisa Spiropali** – Klevis, këto i tha Aldo, i dëgjuam këto. A keni ndonjë gjë origjinale për të thënë? Keni ndonjë gjë të re?

**Klevis Balliu** – Këtu është një pyetje që nuk po bëhet. Nuk është çështja se ju po mendoni pse është ky problem. Për ju, ky nuk është problem dhe ne e dimë, që nuk është problem.

**Elisa Spiropali** – Për rendin e ditës keni ndonjë çështje?

**Klevis Balliu** – Droga për ju është kriter për të ecur përpara. Në qoftë se nuk je i lidhur me drogën, në Partinë Socialiste ti nuk ecën dot përpara. Prandaj ata deputetë të Partisë Socialiste, të cilët nuk kanë lidhje, sot rrinë në karriget e fundit.

**Elisa Spiropali** – Si merrni guximin dhe ofendoni deputetët e maxhorancës? Si ka mundësi që këtu, në këtë komision, lejohet që të ofendohen kolegët e maxhorancës?!

**Klevis Balliu** – Të njëjtat diskutime, të njëjtat mbrojtje i bënit ju deri dje Saimir Tahirit? U deshën 4 vjet që ky njeri, që kanabizoi një vend të tërë, ky njeri që drogoi një rini të tërë

shqiptare, të rrijë sot në arrest shtëpie?! Ne nuk do të presim çdo 4 vjet për çdo drogmen, narkotrafikant që ju keni.

**Elisa Spiropali** – I bëj thirrje kryetarit të komisionit... Klevis, në rregull i dëgjuam.

**Klevis Balliu** – Sa për atë “Babalen” që thoni ju, në çdo vend të botës çdo bos i narkotrafikut, çdo bos i mafies, nuk është kapur nga një përgjim me intelektualë, sepse Agroni nuk fliste me intelektualët, me këta fliste, sepse i kësaj bote ishte Agroni. Ai ishte i narkotrafikut, me ata do të përgjohej, sepse nuk kishte me kë të fliste tjetër. Ju prisnit që narkotrafikantët të flisnin me Ismail Kadarenë? Me atë do të fliste, sepse ky është niveli ku e keni çuar ju Partinë Socialiste, ky është niveli që ju po çoni qeverinë shqiptare dhe flisni këtu për integrim? Kujt i tregoni integrimin?! Partisë që liberalizoi vizat, partisë që tha statusin kandidat.

**Elisa Spiropali** – Klevis, këto i tha Aldo.

**Klevis Balliu** – Partisë që lindi me shprehjen: “Shqipëria si gjithë Europa”. Kush? Ju që bërtisnit nëpër sallat e parlamentit nëpër botë se do të largohen 2 milionë shqiptarë? Erdhët ju dhe u larguan 560 mijë shqiptarë, sepse inkriminuat të gjithë institucionet e shtetit.

**Elisa Spiropali** – I bëj thirrje kryetarit të komisionit, që ta kthej në normalitet këtë komision, sepse po bëhet shumë qesharak.

**Klevis Balliu** – Morët paratë e buxhetit shtetit për të bërë vila, saraje, makina për veten tuaj dhe sot vini të tregoni pjesën morale.

**Elisa Spiropali** – Klevis, për ato shiko në pasqyrë.

**Klevis Balliu** – Te Komisioni Ekonomisë, që nuk pata mundësi që ta thosha, gjithsecilit deputet t’i vijë zor nga vetja, sepse është hera e tretë që sulmohen gazetarët pafytyrësish nga individë, të cilët nuk kanë lidhje me etikën. Ai që drejton atë komision, jo më larg se 4 vjet më parë, përdorte fjalorin më të ndryrë kundër deputetit të Partisë Demokratike, brenda sallës së parlamentit, dhe sot na flet për etikë.

**Elisa Spiropali** – Klevis, nuk të dëgjon njeri.

**Klevis Balliu** – Kjo është hipokrizia juaj. Në vend të ngriheni këtu dhe të thoni jo, mor zotëri, nuk e duam këtë ministër!

Nuk e di a ka lidhje Fatmir Xhafaj me drogën dhe as më intereson fare, por kur ti i bën veting policit të shtetit, a ke ti lidhje, a ka familja jote, a ka lidhje shoku juaj me drogën dhe e heq atë nga puna për atë 400 mijë lekë në muaj, ndërkohë ministri i Brendshëm e ka vëllanë direkt të lidhur me drogën, e ka vëllanë të dënuar. Ky do të jetë trupi juaj! Vetëm për këtë gjë do të mbaheni mend ju dhe kjo qeverisje: për drogën, për inkriminimin e institucioneve të

shtetit, do të mbaheni mend për Mark Frrokun, për Elvis Roshin, do të mbaheni mend për Saimir Tahirin, do të mbaheni mend për Arben Ndokën. Këta janë ministrat tuaj të vërtetë, këta janë ata që ju drejtojnë ju, prandaj nuk pipëtin zë në Partinë Socialiste. Sa për prokuroren, Elisa, nuk ke nevojë ta presësh, se do ta kesh ose te bunkeri i Ramës ose do ta kesh te partia. Ne e dimë se çfarë do të thotë ajo.

Faleminderit!

**Petrit Vasili** – Urdhëroni, zonja Rista!

Më pas fjalën e ka zonja Pampuri.

**Adelina Rista** - Faleminderit, zoti kryetar!

Kam respekt për këtë komision dhe për deputetët anëtarë të këtij komisioni, por sot si anëtare e këtij komisioni, e ndiej veten të fyer, për arsye se kur vijmë përpara kemi një rend dite dhe vijmë të përgatitur për rendin e ditës, dhe këtu dëgjojmë lloj-lloj broçkullash, që na lidhin me krimin dhe drogën, kur nuk kemi fare asnjë lloj lidhje as me krimin dhe as me drogën. Përkundrazi, jemi në luftë të fortë, jemi në front për luftën kundër krimit të çdolloj natyre dhe kundër drogës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zotërinj të nderuar, hallin e madh nuk e kemi ne, që sot keni populluar komisionin tonë; hallin e madh e keni ju, që nuk dini si do të dilni nga kjo histori, të cilës i keni hyrë. Sa për inteligjencën e popullit shqiptar, është kaq inteligjent, sa skenarin tuaj e ka lexuar me kohë dhe loja juaj në skenën teatrale nga ngelur pa spektator, jeni aktorë shumë të këqij, që keni ngelur pa spektatorë. Po dilni shëtitje komision më komision, sepse doni ta përdorni këtë mikrofon si mikrofonin e selisë së Partisë Demokratike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zotëri i nderuar, ky nuk është mikrofonin i Partisë Demokratike, ky është mikrofonin i këtij komisioni të nderuar dhe sot jemi këtu, pikërisht, për atë rend dite që kemi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mbylle gojën dhe qëndro aty, sepse nuk të ndërhyra fare! Mos bëj zhurmuesin, siç e ke zakon të bësh zhurmuesin si në parlament, edhe këtu. Mua nuk më tremb dot, sepse këtu, zotëri i nderuar (je në moshën e djalit im), nuk më ka sjellë as krimi dhe as droga. Këtu etiketove deputetët, sikur i ka sjellë krimi dhe droga, këtu nuk më ka sjellë askush, përveç punës sime të

ndershme. Kaq po të them, sepse nuk ke ardhur këtu për të bërë pis deputetët, qëndro dhe mbaji vendin tënd si dëgjues! Boll na fole broçkulla!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Petrit Vasili** – Të lutem, Klevis, pusho!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Adelina Rista** – Zoti kryetar, unë e kam me ju. Ky komision sot ndihet i fyer dhe është përgjegjësia juaj si kryetar i komisionit që mbledhja arriti në këtë pikë, pasi keni shkelur çdo lloj procedure...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Absolutisht jo, ne kemi një rend dite dhe duhet t'i qëndrojmë rendit.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Zotërinj të nderuar, keni ardhur këtu dhe keni populluar komisionin, a keni ndonjë gjë për rendin e ditës?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kjo nuk është selia e SHQUP-it, ky mikrofon është mikrofoni i komisionit. Dakord?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, aspak, keni dalë jashtë rendit të ditës dhe jeni duke e fyer këtë komision të nderuar, na keni fyer të gjithëve një për një. E pra, loja juaj ka mbetur pa spektatorë...

**Petrit Vasili** – Më falni...

**Adelina Rista** – Ju po bëni thirrje në këtë komision për datën 26 maj...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kundër drogës është shprehur e gjithë qeveria dhe deputetët, edhe siç jua thashë, jemi në frontin e parë të luftës kundër drogës dhe kundër krimit. Kemi bërë dhe kemi aq shumë për të bërë, ndërsa ju po e minoni këtë.

**Elisa Spiropali** – Zoti kryetar, a do t'i ktheheni rendit të ditës?

**Adelina Rista** – Ju kërkoj të miratojmë rendin e ditës. A ka propozime për rendin e ditës?

Jua kërkoj juve si kryetar ta fusni këtë komision në rrjedhën e punës normale, sepse është jashtë normalitetit deri tani.

Unë ndihem e fyer në këtë komision, na keni fyer të gjithëve!

Faleminderit!

Të votojmë rendin e ditës, ndryshe ne duhet të mbajmë qëndrim. Zonja nënkryetare si grup i Partisë Socialiste...

**Orjola Pampuri** – Zonja Rista, a mund ta marr fjalën?

**Adelina Rista** – Nuk kam mbaruar akoma...

**Petrit Vasili** – Të lutem, të mbaroj zonja Rista!

**Adelina Rista** – Edhe një herë, zoti kryetar, në respekt të pozicionit tuaj si kryetar i komisionit, në respekt për atë çka jeni në atë karrige, kërkoj ta fusni komisionin në rrjedhën e normalitetit. Deri tani ka qenë jashtë normalitetit zhvillimi i punës në këtë komision, prandaj ju kërkoj të merreni me rendin e ditës dhe ta miratojmë atë, ndryshe do t'i propozoj grupit të Partisë Socialiste që ne të mbajmë qëndrim.

Faleminderit!

**Petrit Vasili** – Zonja Pampuri, fjala për ju.

**Orjola Pampuri** – Në fakt, dua të vijoj atë që thanë kolegët, por kryesisht atë që tha zonja Rista, që ndihemi të fyer. Në fakt, sot të fyera ndihen dy kategori të rëndësishme ose dy grupe të mëdha.

Të parët janë mjekët, të cilët i përfaqësojmë të gjithë këtu, sepse jemi Komisioni i Shëndetësisë dhe i Çështjeve Sociale, duke e nisur me çështjen që na lidh më shumë. Ata ndihen të fyer, sepse ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, ndoshta edhe ajo e ndikuar apo e dehur nga substancat psikotrope, ka hequr dhe shkarkuar 27 mjekë me përvojë të gjatë disavjeçare në profesionin e tyre nga sistemi shëndetësor, mjekë, juristë dhe ekonomistë dhe këtë ju e dini mirë.

Sot të fyer ndihen të gjithë qytetarët që ju dhe ne bashkë, por ne të paktën jemi të pastër, sepse asnjëri prej nesh nuk ka as vëlla dhe as motër të përfshirë në trafikun e drogës, nëse ka na e thoni, ne jemi të pastër dhe mirëpërfaqësojmë. Të paktën një pjesë e mirë juaja janë zotërinj të nderuar dhe mos u bëni pjesë e atij llumi, mos u bëni pjesë e implikimeve të tilla, të cilat e kanë shndërruar këtë qeveri si një film aksion, e kanë shndërruar punën e kësaj qeverie si një lojë shahu, ku lojtari është lojtari hilacak Edi Rama, i cili heq dhe vë gurët e shahut, ministrat, sipas lidhjeve dhe interesave që ka me vëllezërit, kushërinjtë, motrat apo ku e di unë se çfarë lidhjesh kanë. Ajo që ne kemi është se morali i kësaj qeverie ka rënë. Të paktën për moralin e qytetarëve ta ngremë zërin dhe të mos mbrojmë një gjë kaq të pistë dhe të themi që nuk është e vërtetë. Përballë një të vërtete të madhe, përballë të vërtetës ku droga është përhapur nga shkolla 9-vjeçare, në të mesmen dhe në universitet; përballë të vërtetës ku në çdo stacion televiziv dëgjojmë vetëm drogë; përballë të vërtetës ku kemi dëgjuar banda nga më të tmerrshmet, që edhe në filma, të cilat nga fëmijëria deri më sot nuk i kisha parë ndonjëherë, të paktën për këtë mos e ngrini zërin. Morali i kësaj qeverie ka rënë, të paktën...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Të lutem, mos më ndërprit!

*(Diskutime pa mikrofon)*

Keni ish-ministrin...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Elisa, kur ti fole nuk të ndërpreva, prandaj mos më ndërprit, të lutem!

*(Diskutime pa mikrofon)*

Të paktën unë jo...

**Elisa Spiropali** – Nuk mund të thoni të paktën një gjë kaq...

**Orjola Pampuri** – Ish-ministrin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem Elisa, ish-ministrin e keni në arrest shtëpie, vëllai i ministrit është i akuzuar për trafik droge. Tani, ju lutem, morali i kësaj qeverie ka rënë, mos u bëni pjesë e dhunës!

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elisa Spiropali** – Kryetar, ne do të detyrohemi që të mbajmë qëndrim në këtë komision. Fakti që disa komisione drejtohen nga kolegë të opozitës nuk u jep të drejtën t'i privatizojnë dhe t'i përdorin si pronë të babës. A ka mundësi, ju lutem, t'i kthehemi rendit të ditës? Çfarë kishit për të thënë e thatë.

**Bardh Spahia** - Çështja e ditës është droga, Elisa. Ne këtu jemi për shqiptarët, nuk jemi për ju. Unë e kuptoj që ju jeni të kapur nga interesat e trafikantëve, jeni në mbrojtje të plotë të trafikantëve, jeni në mbrojtje të drogës. Këtu në komision kjo pjesë e deputetëve e ulur këtej është për interesat e qytetarëve, Elisa. Nuk do të ketë forcë që do të na e mbyllë gojën për sa kohë jemi në mbrojtje të interesit të qytetarëve. Ju doni të mbronin interesat e trafikantëve, vazhdoni, por jeni gabim!

**Elisa Spiropali**- Uleni zërin, ju lutem! Përgjigjen do ta merrni si asnjëherë tjetër.

**Bardh Spahia** – Ju doni të mbronin interesat...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Petrit Vasili**- Zonja Bello.

**Bardh Spahia** – Jeni të lidhur me drogën, më shumë se kaq nuk di çfarë duhet të thuhet në këtë vend. Jeni të lidhur me drogën, jeni në mbrojtje të drogës, reflektoni. Po ju përmend një shprehje të Xhovani Paolos II, i cili thotë: Pendohuni!

**Petrit Vasili**– Po, zonja Bello.

**Vilma Bello** -Arsyeja pse e mora fjalën në komision është se ndihem e detyruar si një deputete e qytetit të Vlorës, i cili ka njerëz të mrekullueshëm, që jetojnë denjësisht në atë qytet dhe punojnë po aq denjësisht në atë qytet. Nuk ka lidhje etiketimi i një qyteti si Vlora me krimin. Vlora është histori, bukuri, është gjithçka që të gjithëve bashkë duhet të na shtojë përgjegjshmërinë për të mos përdorur kauza të tilla si “Babalja”, të cilat ju bëjnë qesharakë. Me një fytyrë të zgjedhur në kauzën tuaj si Albert Velu për të ngritur kauzën e radhës dhe për të vërtetuar përgjegjshmërinë përballë qytetarëve...

Ju lutem, mos më ndërprisni, zoti Spahia!

Unë nuk kam ardhur këtu si deputete e drogës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti kryetar i komisionit, a mund të vazhdoj?

Zoti kryetar, është përgjegjësia juaj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Petrit Vasili**- Ju lutem, pushoni!

Po, zonja Bello

**Vilma Bello**- Me keqardhje ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Petrit Vasili** - Bardhi, mjaft të lutem!

Po, zonja Bello.

**Vilma Bello** – Me keqardhje po ju them që kolegët e opozitës na etiketuan si deputetë të ardhur nga droga dhe jam duke folur për deputetët e Vlorës...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Të lutem, mos më ndërprit, Bardh Spahia!

Asnjë nga deputetët e Vlorës, madje mendoj se asnjë nga deputetët e Vlorës, edhe ata opozitës, nuk kanë ardhur në parlament prej drogës, përkundrazi...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Mos më ndërprit, Bardh Spahia...

**Bardh Spahia** – Po ta konfirmoj...

**Vilma Bello** - Jo, mos më konfirmo, sepse nuk kam nevojë për konfirmimet tuaja, jam në gjendje të flas vetë, të konfirmoj dhe të besoj në ato që jam duke thënë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Petrit Vasili** – Mjaft, Bardhi!

**Vilma Bello** – Bëni mirë të mos më ndërprisni, siç nuk ju ndërpreva në asnjë moment të ligjërit tuaj të çuditshëm...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Të dëgjuarit dhe të folurit nuk shkojnë bashkë.

Kam dy pyetje për kolegët e opozitës: së pari, e dëgjova kërkesën tuaj për dorëheqjen e Fatmir Xhafajt. Është turp, turp dhe turp e thënë nga ana juaj, por nuk e di nëse është më shumë turp apo është frika juaj e brendshme për të ruajtur veten nga reforma në drejtësi që ka nisur...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Mos qeshni, mendojeni dhe bëni mirë të jepni një përgjigje të menduar...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Së dyti, nga kryetari i grupit tuaj parlamentar dëgjova që ju do të hyni, ju do të merrni integrimin dhe ju do të bëni gjithçka...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ne jemi shqiptarë dhe kjo është ajo që na diferencon, integrimi nuk është për ne, i dashur koleg i opozitës, është për shqiptarët dhe nuk u ofroheni dot shqiptarëve duke u thënë ju dhe duke veçuar veten. Të bëhemi bashkë në këtë proces, i cili u shërben shqiptarëve dhe jo neve, por nuk jeni personat...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Sa për audiopërgjimin, lërojani prokurorisë dhe pastaj të flasim të qetë, se sa kohë nuk jemi të qetë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jemi shumë të ndarë, zoti Spahiu, por bëni mirë të mos e etiketoni gjithë Vlorën si qytet të drogës dhe të krimit, përkundrazi, është qyteti i lavdisë.

Faleminderit, zoti kryetar!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Petrit Vasili** – Faleminderit, zonja Bello!

Po, zonja Duma.

**Grida Duma** – Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë të maxhorancës,

Të nderuar kolegë të opozitës,

Jam e bindur se ka një politikë për t'u bërë për kamerat, ka një politikë për t'u bërë për ndërgjegjen, ka një politikë për t'u bërë për vendin dhe nuk ka asnjë çudi në këtë që po ndodh sot, sepse shqiptarët janë mësuar, na shohin në kampe, një palë po e një palë jo.

Po ju dëgjoja me vëmendje, jua them me siguri se kam vërtet respekt për disa nga ju, por kjo nuk është aspak një çështje diplomacie. Shpresoja që Adelina, kur ta merrte fjalën, ashtu siç e ka marrë fjalën me forcë për shumë gjëra të vërteta dhe unë e kam dëgjuar dhe e respektoj për trajtimin e projektligjeve, të thoshte edhe një pjesë të kësaj të vërtete, e cila nuk është politike.

E di shumë mirë që edhe kolegja nga Vlora, i di të vërtetat. Jam e bindur që edhe mjekët këtu, të cilët nuk prononcohen, i dinë të vërtetat.

Le të flasim një moment jo si shqiptarë me patetizma, sepse në fund fare jemi po ne që e dimë se në momentin kur na kërkohet një këshillë nga një student, nga një mik, nga një i ri apo re, të cilët na kërkojnë të rrinë në Shqipëri apo të ikin në Gjermani, se ka një vend pune më të mirë, jemi të parët që mendojmë për të mirën e tyre individuale dhe u themi: ku të jeni ju më mirë atje duhet të shkoni.

Ne tashmë jemi qytetarë me një lloj ndërgjegjeje perëndimore dhe e dimë se ku duhet të shkojë ky vend. Unë e di se secili prej nesh e di shumë mirë se cila duhej të ishte procedura e vërtetë, po ashtu e di që brenda maxhorancës ka njerëz të sakrifikuar, kamikazë për të mbrojtur një çështje të pambrojtshme dhe më vjen keq kur i shoh. Për disa prej tyre më vjen keq, sepse kanë shkollime perëndimore, për disa të tjerë më vjen keq, sepse e kuptoj që janë të detyruar.

Unë e di shumë mirë se nuk ka nevojë për sondazhet që kanë dalë në faqet prestigjioze, ku e barazojnë Kryeministrin me një ish-trafikan në besueshmëri për ta kuptuar se në çfarë situatë është Shqipëria.

Të nderuar kolegë të maxhorancës. Për parim, jemi sot në një moment në të cilin Partia Socialiste pa asnjë koment për të, i ka të gjitha pushtetet. Keni pushtetin e drejtësisë, keni pushtetin e ekzekutivit, keni pushtetin mediatik. Ne e dimë po ashtu se nuk ka nevojë për shumë memorie të gjatë, sidomos të Adelinës apo të ndonjë kolegu tjetër që është brezi im dhe më tej, për të kujtuar se si ekranet e televizioneve dikur buçisnin në orën 20:00 për realizimet 102%, 103 %, por shqiptarët ishin në mjerimin më të madh jo vetëm ballkanik, jo vetëm europian, por ndoshta në mjerimin ekonomik dhe varfërinë shpirtërore më të madhe globale, si një popull që jetonte në mes të Europës, në mes të qytetërimeve më të vjetra, ne përfundam të shterojmë çdo gjë. Por ajo që kemi shteruar më shumë nga të gjitha është

minimumi i një tabani mes nesh. Kjo çështje, çështja e përgjimit, e videos, e kush ka inteligjencë e kush nuk ka të tillë është e pakoment në përmasën në të cilën ne nuk pranojmë një taban. Është e vërtetë, njerëzit e dinë se është e vërtetë. Problemi është se si duhet ta rregullojmë. Të jeni të sigurt se ka nevojë për disa nga ju për ta rregulluar. Sigurisht, sot nuk mundeni më në vitin e pestë për çdo gjë që nuk shkon të thoni: “Opozita”. Ju ka ndjekur me vëmendje, me qytetari, me vështrimin si komunikim. A doni t’ju shikojmë profesionalisht? Nuk gjejmë kurrë një përgjigje që lidhet me ju, me llogaridhënien, sepse jeni në qeveri. Jeni në qeveri, miqtë e mi. Duhet t’ju quajmë miq për t’i thirrur ndërgjegjes suaj. Nuk mundeni sot të mos bëni minimalen njerëzore. Nuk ju ka sjellë thjesht Edi Rama. Unë jam e bindur se Adelinën nuk e ka sjellë thjesht Edi Rama. Ka mes jush njerëz që i kanë sjellë qytetarët. Ka mes jush njerëz që besoj si edhe unë besojnë se një ditë do të dalim nga politika dhe nuk duhet të kemi këto pendime brenda. Këto pendime që nuk thamë kurrë dy të vërteta, për të cilat disa njerëz që ndoshta nuk na njohin fare, na shikojnë në sy, sepse duan njerëz të

vërtetë, sepse të vërtetat e tyre, ju i dini, ne i dimë...

**Elisa Spiropali** – Grida, po ti ndihesh mirë në atë parti, e kam seriozisht?

**Grida Shqina** - E vetmja gjë që duhet të ndihemi...

**Elisa Spiropali** - Meqenëse po na drejtohesh se duhet të ndihemi keq për qeverinë...

**Grida Shqina** - ...mirë sot në politikë si individë, si gra, si nëna, si të doni, me çfarëdolloj statusi social është: a kemi ndopak ndërgjegje me të vërtetën, apo jo? Atë gjë që njerëzit sot e deklarojnë kudo: “Nuk ka më kredibilitet politika”.

Jeni në qeveri dhe nuk jeni sot në asnjë pozicionim në të cilin të jepni të paktën një përgjigje, jo një llogaridhënie. Nuk ka një përgjigje nga ju për asgjë. Ka vetëm një akuzë, megjithëse keni pushtet. Nuk ka ndodhur dhe nuk mund të ndodhë që kjo të zgjasë gjatë.

**Elisa Spiropali** - Cilat janë pyetjet që nuk merrni përgjigje?

**Grida Shqina** - Jua them këtë për parim historik. Jeni në paradoks historik. Gjëja e vetmja që duhet t’ju këshillonin mirë, nuk do të ishin batutat me baballarë, nuk duhet të ishte kjo, por duhet të ishte: “Thoni minimumet e të vërtetave, sepse përndryshe do të rrëshqasim që të gjithë! Pranoni disa minime të të vërtetave dhe heshtni për gjërat që nuk mund të gënjeni trashë, sepse do të rrëshqasim që të gjithë!”. Kjo ishte ajo që duhej thënë.

Ju e dini shumë mirë në sa faulle jeni. Shqiptarët përveçse mbajnë mend 101% realizime programesh, kujtonin edhe shokun mental të tyre kur panë në çfarë mjerimi ishin. Sot nuk janë në atë gjendje. Sot e dinë dhe ndoshta na gjykojnë herë pas here dhe në ato gjëra

që tentojmë t'i bëjmë mirë, nuk na besojnë më. Mendojnë se po i bëjmë keq, po i bëjmë për interesat tona, për arsye sepse nuk ka një minimum të vërtetë në gjithçka që thoni ju.

Tani, a është këtu vendi të themi se dikur jo shumë vite më përpara thoshit: "Janë mushkonja" për aeroplanët. "Janë mushkonja", thoshit dhe dolën aeroplanë. "Është kamionisti Saimir" dhe doli ministri Saimir. Nuk ka kanabis Shqipëria, por shikoni se po e luftojmë prandaj po kapet. Nuk ka një fakt të vetëm, i cili sot qëndron në këmbë për t'ju mbajtur juve kolonat e asaj që iu kanë vënë përgjegjësi për të mbrojtur.

Unë kam një pyetje tjetër dhe pyetja është kjo: po si ka mundësi që dëmet nuk i bëni juve personalisht dhe mbani këtë peshë personalisht?! Nuk i keni bërë dëmet ju! Nuk i ka bërë as kjo zonja këtu. Nuk i ka bërë as ajo zonja atje. Ju i mbani personalisht dhe bërtisni pa pasur një minimum normaliteti që të kuptoni: "Po, e drejta është me anën tjetër". Nëse ka një mënyrë për ta balancuar të drejtën që është në anën tjetër, është të heshtni. Nuk jeni ju ministri i Brendshëm që bëheni mbrojtës të tij! Është 2 herë gabim. Është 2 herë keq. Është 1 mijë herë pendim në jetët tuaja. Këtu nuk fshihen dot pas teknikiteve, spiunëve të prokurorisë, faktit që dini fakte të brendshme dhe i thoni publikisht, faktet që e kuptoni qartazi se jeni duke thënë një herë çështje ekspertize që 2 orët e para, pastaj 3 orët e para ekstradim. Se sa e vërtetë apo jo është çështja, atë e provon produkti. Produkti sot është se deri në 5-6 vjet një individ, vëllai i ministrit të Brendshëm nuk është dënuar, nuk është vetëdorëzuar. Pas këtij fakti, ai shkoi në Itali dhe po vuan dënimin. Fakti është aty. Faktet flasin përtej nesh. Njerëzit na dëgjojnë me mëndje, por edhe me një gjë tjetër, me shpresën: a duhet vërtet të mendojnë se dy gramë jetë vlen të jetë në Shqipëri. A do të mendojmë ndonjë moment për shqiptarët, dhe jo për ministrat, që nuk shfaqen asnjëherë këtu për të dhënë llogari? Ne kemi qenë në këtë komision, të gjithë bashkë. Po kalon viti, po vjen viti; më thoni sa herë keni parë ministra që japin llogari? Pothuajse zero. Nuk kanë ardhur, jo s'i kemi kërkuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

I kemi këtu procesverbalet. Mos bëni...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mirë. Gjëja më e vogël në botë është të mbeteni te kjo.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Tani, nga ana tjetër, unë ju them: në komunikimin publik unë kam parë vetëm atë zonjën atje, që del e mbron ministër pas ministri. Vetëm ajo zonja atje. Dhe ai ministri nuk del kurrë të vetëmbrohet e të japë llogari. Ndoshta do të të shoh ty një ditë, ndërsa Adelinën një ditë tjetër, por nuk do të ndjehem mirë. Do të doja t'ju shihja juve, ndoshta t'ju shihja juve ministre,

t'ju shihja juve të jepni përgjigje, sepse jam e bindur se zgjidhje për këtë problem ka. Ky nuk është më problem politik, por problem i një bashkësie të vërtetash, që nuk mohohet dot më. Në këto kushte në të cilat jeni, unë shpresoj që të mos e rimerrni fjalën për të bërë gramafonin, sepse më vjen keq kur ju shikoj të shpërdoruar, megjithëse keni arsye për të heshtur, në qoftë se nuk thoni dot as minimumin e të vërtetave.

Faleminderit!

**Petrit Vasili** – Po. Zonja Spiropali.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po.

**Adelina Rista** – Dy fjalë, meqë ma përmendi emrin disa herë.

Kam respekt për ju, zonjë e nderuar, kam respekt për formimin dhe background-in që ju keni, për mënyrën se si i trajtoni gjërat, për qetësinë me të cilën i trajtoni. Edhe një herë: respekt për ju!

S'kisha ndërmend ta merrja fjalën përsëri, por meqë ma përmendët emrin disa herë, për respekt të kësaj dua t'i them dy fjalë.

Për mua parimet janë të shenjta, janë vërtet të shenjta. Dje janë parimet ato, mbi të cilat jam edukuar, jam kalitur, kam ecur deri këtu dhe jam sot këtu. Luftoj fort për ato parime tek të cilat besoj.

Në këtë këndvështrim, dua të them se në fjalën time, por edhe në fjalën e kolegëve këtu, askush prej nesh nuk mori në mbrojtje krimin dhe drogën. Absolutisht jo! Përkundrazi, jemi distancuar fort nga krimi e droga, dhe ju thashë se kjo qeveri është në llogore të luftës ndaj krimit e drogës. Por, e përsëris: si anëtare e këtij komisioni, unë ndjehem e fyer kur një deputet. jo anëtar i komisionit, por me të drejtën e tij për të marrë pjesë në këtë komision, me të drejtën e tij të fjalës për të marrë pjesë në këtë komision, fyen tekstualisht me fjalët: askush nga ju nuk mund të ecë pa u mbështetur nga krimi dhe droga! Secilit prej jush e ka sjellë këtu krimi dhe droga!”

Jo, zotëri i nderuar! E them dhe e rithem disa herë këtë gjë: ne nuk jemi pjesë e drogës. Nuk kemi ardhur nga krimi dhe droga, por kemi ardhur pikërisht me kauzën e luftës ndaj korrupsionit dhe luftës ndaj krimit e drogës. Sot jemi këtu pikërisht për këtë arsye, dhe pikërisht për këtë arsye na u dha mandati i dytë. Distancohemi nga çdo lloj gjëje. Por, e thashë, unë parimet i kam të shenjta. Mbi gjithçka, unë besoj te drejtësia. Tashmë, kjo është pjesë që i takon drejtësisë. Ta lëmë drejtësinë të flasë, dhe le të besojmë të gjithë te drejtësia. Këtë duhet ta besojnë të gjithë shqiptarët.

Shqiptarët, e thashë edhe një herë, janë aq inteligjentë, sa skenarin e kanë lexuar të parët, dhe lojën tuaj autoriale e kanë lënë tashmë pa spektatorë. Kjo po kthehet në një lojë qesharake.

Ju lutem, zotërinj të nderuar: jeni të nderuar në pozicionet tuaja, ta lëmë këtë dhe t'i kthehemi punës normale në komision. Le ta përdorim mikrofonin për komisionin, ndërsa këtë propagandë, që është politike dhe s'ka lidhje me këtë komision, ta lëmë te selia e partisë, ta lëmë te mikrofonët e tjerë të konferencave për shtyp, le ta lëmë atje ku bëhet, por jo këtu. Këtu le t'i kthehemi rrjedhës normale të komisionit, të rendit të ditës dhe të bëjmë punën; t'u kthehemi përgjegjësive tona si deputetë në komision, në detyrat që kemi këtu në komision.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ajo është pjesë tjetër.

Faleminderit!

**Petrit Vasili** – Ju lutem, mos ndërhyini!

Po, zoti Spaho!

**Edmond Spaho** – Tani ju po na thoni se ne jemi angazhuar në një teatër dhe po përpiqemi ta instrumentalizojmë për interesat tona politike.

Jeni thellësisht gabim. Unë e di se juve ju duhet të reagoni kështu, por shqetësimi ynë është shumë i madh, e kjo për shkak se vendi ndodhet para një sfide: sfida e integritetit, për të cilën ka njëzet e shtatë vjet që punojmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Por sfida e integritetit është ndeshur me një pengesë shumë të madhe, që ju e dini shumë mirë se është nevoja për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Këtë çështje nuk e ka shpikur opozita, por është produkt i qeverisë suaj. Pavarësisht sa themi ne këtu brenda dhe ju nuk dëgjoni, mesazhin e keni marrë jashtë, kudo ku keni shkuar të interesoheni për çështjen e integritetit. Kryeministri juaj ishte në Gjermani dhe mesazhi që mori ishte “Luftë ndaj krimit të organizuar”, “Dorëzo Saimir Tahirin!” “Mos e mbro!”; erdhën deputetët holandezë dhe ju thanë të njëjtën gjë. Shqipëria ka problem të madh me krimin e organizuar, me trafikun e drogës.

Shkoi Kryeministri në Francë dhe mori të njëjtin mesazh nga presidenti Makron. Krimi i organizuar, trafiqet, madje shto edhe trafikun e njerëzve, të qytetarëve, që në Francë dhe në Angli është bërë problem për këto vende.

Shkuat në Sofje në samit, të njëjtën gjë ju thanë, si iku, u kthye Kryeministri. Optimizmi i madh ndeshi në qëndrimin e prerë të Europës. Po nuk treguat me prova konkrete që do të kapni krimin, i cili është shtrirë në qeveri, nuk ka integrim.

Tani ju thoni se jeni distancuar nga krimi i organizuar, jeni në llogore duke luftuar drogën e të tjera e të tjera. Nën qeverisjen tuaj është miratuar ligj për dekriminalizimin. Jemi i vetmi vend në botë që kemi ligj për dekriminalizimin. Kush e kriminalizoi Kuvendin e Shqipërisë? Ju. Ju i sollët.

A ishte Kryeministri juaj që thoshte se nuk kam asnjë nga opozita? Si doli pastaj? A ishit ju që futët krimin në pushtetin vendor?

I kujt është Elvis Roshi?

**Elisa Spiropali** - Jeni kryetar grupi. Kemi seancë të enjten dhe mund të flisni atje. Po s'ka kuptim kjo gjë tani.

**Edmond Spaho** – ... Elvis Roshin, këtë të Durrësit, atë të Elbasanit, ata ministrat që janë të përgjuar kur bëjnë pazare për të blerë vota me paratë e drogës, kush i ka? Ne i kemi? Ju i keni.

Atëherë si qenkeni ju në llogoren e luftës kundër drogës dhe krimit?

Çfarë ju tha presidenti i Komisionit Europian?

**Elisa Spiropali** – Lexoni raportet!

**Edmond Spaho** – Erdhi këtu, iku në Serbi dhe sa arriti, tha se Shqipëria ka një problem të madh, krimin e organizuar dhe nuk kemi ndër mend ta eksportojmë në Europë.

Pra, këto janë shqetësime të mëdha, të cilat edhe juve duhet t'ju tërheqin vëmendjen dhe të kërkonin të ushtroni presion.

Nuk them se i gjithë grupi parlamentar i PS-së është i lidhur me krimin e organizuar ose ka ardhur nga droga. Asnjëri nuk e ka thënë këtë, se edhe në PS ka njerëz të ndershëm sa të duash, prandaj ju bëjmë thirrje që ju, në pozicionet që keni, në funksionet që keni, të ushtroni presion në mënyrë që pjesa e shëndoshë të triumfojë mbi pjesën e kalbur.

Si mund të shkohet në Europë, se thoni që ju pengon opozita, kur dy ministra të brendshëm njëri pas tjetrit janë të lidhur me krimin e organizuar?

A thatë ju për Saimir Tahirin ...

**Elisa Spiropali** – Asnjë lidhje nuk ka ministri i Brendshëm me trafikun e drogës, asnjë çedim, asnjë provë, asnjë fakt. Kjo është një baltë që ju e hidhi pa kursim.

Ju lutem, lëreni gjykatën të vendosë!

**Edmond Spaho** – A është në arrest shtëpie?

**Elisa Spiropali** - Asnjë provë nuk na keni dhënë as për atë, prandaj na lini të shohim këtë çështje.

More zotëri, ministri i Brendshëm është në detyrë.

**Edmond Spaho** – A mund të më tregosh një vend të Europës ku ministri i Brendshëm e ka vëllanë në burg për krijim të organizatave kriminale dhe trafik ndërkombëtar droge?

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Elisa Spiropali** – Njihni ndonjë vend të botës ku lideri i opozitës i është shmangur gjykimit me procedurë mjekësore?

Njihni ndonjë vend, kur ai ka qenë ministër dhe janë vrarë 4 persona në mes të bulevardit dhe asnjë nuk mban përgjegjësi? Këtë lloj vendi e njihni ju?

A e njihni apo jo këtë lloj vendi, zoti Spaho?

Njihni ndonjë vend ku ish-Kryeministri organizon vrasjen e 26 njerëzve në një fshat të vendit dhe nuk mban përgjegjësi?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jeni të zhytur aq thellë sa nuk dini çfarë thoni.

**Edmond Spaho** – Pse e kërkojmë dorëheqjen ne? Si do t'ia bëjë me ligjin antimafia tani?

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Elisa Sapiropali** – Nuk jua japim dot votat që ju mungojnë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Edmond Spaho** – Se ligji thotë edhe familjarët, prandaj ai duhet të verifikojë dhe të sekuestrojë edhe pasurinë e vet. E bën dot ai këtë? Nuk e bën dot se është në konflikt interesi, prandaj duhet të japë dorëheqjen. Pastaj ka edhe një anë morale. Si mund të shkojë ministri i Brendshëm të takojë kolegët e tij, kur ata e dinë se ky e ka vëllanë në burg?

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Elisa Spiropali** - S'kishte urdhër ekstradimi. Thatë që ka infiltruar një nen, doli se nuk ishte ashtu.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Çfarë po thoni?

**Edmond Spaho** – E ka vëllanë në burg, të akuzuar për krim të organizuar, ministri i Brendshëm. A e kuptoni, apo jo, se çfarë po thoni?

**Elisa Spiropali** - Më lejoni t'jua them unë se çfarë keni kërkuar ju dhe çfarë ka dalë si fakt.

**Edmond Spaho** – Për sa kohë Kryeministri gënjen, nuk ka pse të çuditeni me ministrin e Brendshëm.

**Elisa Spiropali** – Edhe njëherë: a ishit ju që thatë, se si kryetari i Komisionit të Reformës në Drejtësi ka infiltruar, si diversant, një nen për të mos lejuar ekstradimin? A doli se ai nen ishte brenda normës? Atë gjë e përgënjeshtroi edhe Bashkimi Europian, zoti Spaho, dhe ju nuk patët turp, por e vazhduat sërish këngën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Tani, edhe nga ajo që tha zonja Duma, por edhe nga ajo që po thoni ju, unë po kuptoj se teatri paska humbur shumë, politika ka fituar shumë pak.

**Edmond Spaho** – Tani po dalin fakte dhe regjistrime, për të cilat Kryeministri, ngaqë nuk ka se çfarë të bëjë, fillon dhe gënjen.

**Elisa Spiropali** – A mund t’i kthehemi politikës në këtë debat?

**Edmond Spaho** – A mund të ma thuash ti se ku i gjeti Kryeministri regjistrimet?! Meqenëse jeni afër tij, a mund ta pyesni se ku i gjeti regjistrimet?

**Elisa Spiropali** – Ju i keni të gjitha hapësirat.

Nuk i ka mbetur Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë për të diskutuar çështjet tuaja.

**Edmond Spaho** – Së dyti, ku e gjeti zërin e Agronit, që e çoi për ta verifikuar?!

**Elisa Spiropali** – Votat nuk jua bëjmë dot ne, por duhet t’i bëni vetë, zoti Spaho!

**Edmond Spaho** – Së treti, ku e çoi për ta verifikuar?!

**Elisa Spiropali** – Po jua them unë.

**Edmond Spaho** – Le të na i thotë këto, sepse janë pyetje që i shtron opozita, i shtojnë qytetarët dhe duhet t’i dimë përgjigjet. Ai doli dhe foli me zë dhe me figurë: “Unë nuk e jap Fatmir Xhafajn, sepse bëra verifikim dhe më doli se është fals”. Atëherë, të na e thotë edhe neve, që të bindemi dhe të shkojmë te kjo kompani, dhe t’i themi se si e bënë verifikimin, na iluminoni edhe neve të paditurit dhe injorantët!

**Elisa Spiropali** – Po jua them unë: deputetët tuaj, që kanë inskenuar këtë turp, dolën para prokurorisë dhe thanë me zë dhe me figurë: “Ne nuk besojmë te kjo prokurori”. Tani, unë them që të zgjidhni “Babalen” kryetar partie, sepse më shumë kaos ka prodhuar ai se sa lideri juaj aktual!

**Edmond Spaho** – A mund të më thuash: si iku ai me vrap në Itali? A e dini se ka procedura? Për të shkuar dhe për të kryer dënimin atje, ai duhej të dorëzohej fillimisht tek

organet tona, duhej të plotësoheshin procesverbalet, të bëheshin procedurat e të gjitha me radhë dhe më pas të dorëzohej.

**Elisa Spiropali** – Kryetar le të jetë “Babalja”, kryetar i grupit parlamentar le të jetë Jetmir Olldashi dhe jeni në rregull! Dakord!

**Edmond Spaho** – Si iku dhe e kapërceu kufirin pa lenë asnjë shenjë, me vrap?

**Elisa Spiropali** – Mos e shani, sepse ju ka dhënë një flamur, që mund ta tundni edhe për disa kohë. Kaq.

**Edmond Spaho** – Pse nuk e kapi prokuroria kur ai shkoi atje dhe bëri denoncimin, sepse ai është një njeri i dënuar në të tria shkallët e gjyqësorit në Itali? Kur shkon në prokurori, prokuroria duhet të të kapë, kurse ti më thua mua se jemi në llogoren e luftës ndaj krimit të organizuar.

**Elisa Spiropali** – Unë nuk e thashë këtë, por thashë se ju jeni të zhytur brenda. Ju jeni zhytur aq thellë dhe po nxirrni këto guriçkat nga andej.

**Edmond Spaho** – Për cilën drejtësi po flet ti? Drejtësia është kjo që ai shkon te prokuroria, prokuroria i rrahu shpatullat, e mori në makinë, e çoi në aeroport, e hipi në avion, u përqaftua me policët, të cilët nxorën edhe një parullë: “Faleminderit Agron” dhe nuk dihet se ku iku!

**Elisa Spiropali** – Frika juaj qenka shumë e madhe, zoti Spaho! Është aq e madhe, sa nuk fund.

**Edmond Spaho** – Me cilën prokurori?! Me këtë që zgjodhët me 69 vota?

**Elisa Spiropali** – Nuk besoni as te prokuroria?

**Edmond Spaho** – E zgjodhët pa veting, të propozuar nga Ulsi? Te kjo prokurori duhet të kemi besim?

**Elisa Spiropali** – Unë jam krenare që kam bërë atë prokurore.

**Edmond Spaho** – Qesharakë jeni bërë ju, jo ne.

**Elisa Spiropali** – Jo po të mbanim atë prokurorin që është i padëshiruar edhe për Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

**Edmond Spaho** – Ju jeni bërë qesharakë me qëndrimet që po mbani. Ju jeni bërë si gamilja që fut kokën në rërë dhe kujton se nuk duket!

**Elisa Spiropali** – Nuk është gamilja ajo kafshë, por ju po ngatërroini edhe kafshët, edhe qëndrimin! Nuk e fut gamilja kokën në rërë, e fut struci!

**Edmond Spaho** – Me struçë, me gamilje, me deve, që e fusin kokën në rërë dhe kujtojnë se me gjithë atë trup të madh nuk duken!

**Elisa Spiropali** – Për ju 7 herë 7 bëjnë 42, gamilja është struc; struci është drogë; droga është ushqim e kështu me radhë! Ky është ushqimi juaj ditor, dakord!

Kaq dini ju.

**Edmond Spaho** – Ejani në vete dhe jepini fund kësaj komedie! I thoni atij të japë dorëheqjen, sepse ka njerëz të ndershëm edhe në PS.

**Elisa Spiropali** – Faleminderit për fjalën tuaj shumë frymëzuese! Dëgjohemi në seancë.

**Edmond Spaho** – Është tërësisht anormale që ky vend të dy ministrat e Brendshëm t'i ketë të lidhur me krimin dhe drogën.

**Petrit Vasili** – Po, zonja Spahiu.

**Klodiana Spahiu** – Faleminderit, zoti Spaho, për fjalën e përsëritur dhe për mbrojtjen që bëtë si kryetar i grupit që jeni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Unë shpresoj që t'u ketë ardhur orari i drekës, që të shkoni dhe të shlodheni, sepse sot, me të vërtetë, u lodhët dhe u konsumuat shumë.

Ju kolegë, politikanë të vjetër, që i dini shumë mirë historitë e kryeprokurorëve në vendin tonë të nderuar, si dhe e dini se si kanë anatemuar dhe çfarë kanë thënë për ta, ju lutem, lëreni drejtësinë të bëjë punën e saj, se është turp i madh që të ndërhyjnë atje ku nuk duhet të ndërhyjnë.

**Bardh Spahia** – Turp ishte që nuk ndërhytë asnjë për Saimir Tahirin. Edhe për Saimir Tahirin nuk duhet të ndërhyjmë, sepse sipas jush duhet të prisnim edhe për Saimirin.

**Klodiana Spahiu** – Të lutem, pushoni!

Të nderuara kolege, politika shqiptare është shumë e ashpër dhe një ish-kolegia jonë e ka thënë me vërtetë që të bëhet lëkura shollë. Është e vërtetë se kur flisni bukur, nuk duhet të harroni që nuk jeni shoqëri civile, por jeni politikanë që përfaqësoni forcën tuaj politike. Në qoftë se ne mbrojmë një program të partisë sonë, në qoftë se mbrojmë një program të qeverisë shqiptare aktuale, na takon ta bëjmë dhe do ta bëjmë deri në fund, duke mos u marrë me poshtërsi dhe duke mos u marrë me njerëz ordinerë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të lutem! Unë e shikoj se të ka ardhur orari i drekës!

**Bardh Spahia** – Po, sepse është e tepët të dëgjosh këto.

**Klodiana Spahiu** – A e kupton se sa e tepërt është të të dëgjosh ty, Bardhi!

E kupton sa e tepërt është, Bardhi?!

**Elisa Spiropali** – Mirupafshim, Bardhi!

**Klodiana Spahiu** – Të bëftë mirë dreka dhe inshallah të kthehen mendtë dhe të vish në komision, sepse kështu nuk keni gjë në terezi!

*(Reagime pa mikrofon)*

**Elisa Spiropali** – Bardhi, të fala “Babales”! Tani nga “duam babën” do të kaloni te “duam Babalen”.

*(Reagim pa mikrofon)*

Nga “duam babën” te “duam Babalen”!

*(Reagim pa mikrofon)*

**Petrit Vasili** – E doni fjalën?

**Nora Malaj** – E mendova shumë mirë para se të flisja. E dëgjova me shumë vëmendje debatin në takimin e sotëm. Jemi përballë një situatë që... Në fakt, politika shqiptare sot është shumë e ngarkuar dhe këtë ngarkesë të madhe e merr pikërisht nga problemet që shfaqen sot. Mendoj se sot në komision kemi një çështje shumë të rëndësishëm, miratimin e kalendarit, i cili pasqyron punën tonë dhe ne nuk mund ta anashkalojmë atë. Duke pasur parasysh edhe ngarkesën reale të sotme, ne duhet të reflektojmë, të debatojmë me njëri-tjetrin dhe të jemi pjesë e debatit politik, përtej programit apo kalendarit që realizojmë së bashku. Them debatit politik, sepse para një jave, kur isha në Austri për probleme shëndetësore, sinqerisht jam ndjerë shumë keq kur në diskutime të pyesnin “ku je, nga je, si ke ardhur”, kuptoj se vendi yt nuk është vendi që ti do të promovosh. Fatkeqësisht, po promovohet me problematika shumë të mëdha, të cilat lidhen me problematika ndërkombëtare dhe jo vetëm kombëtare. Si Komisioni për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale, mendoj se merr një rëndësi shumë të madhe kauza e luftës jo vetëm kundër drogës, por kundër të gjitha fenomeneve që sjell droga dhe pasojat e saj; kauza e fakteve, pra që duhet t’i shohim të vërtetat në sy dhe, absolutisht, të debatojmë dhe të dialogojmë pa e fyer njëri-tjetrin dhe pa krijuar konotacione negative; kauza, ku secili nga ne, si pozitë dhe opozitë, duhet të marrë përgjegjësinë e tij për ta çuar deri në fund atë që quhet luftë frontale për interesin e kombit; kauza, që kur të flasim më 1 Qershor, në një nga ditët dhe festat ndërkombëtare të fëmijëve, të bëjmë analizën për gjendjen e fëmijëve tanë dhe japim edhe rezultatet e para, por, sigurisht, nuk na vjen mirë kur përballemi me fenomene, të cilat sot, më shumë se kurrë, kapin këto kategori fëmijësh. Mendoj se, kur flasim për dialog pozitë-opozitë, nuk duhet të mërzitemi me njëri-tjetrit dhe as ta fyejmë njëri-tjetrin. Le t’i lemë organet e drejtësisë të bëjnë punën e tyre; le të bëjmë ne punën tonë; le ta shohim komisionin me

dëshirën për t'u dhënë zgjidhje problemeve, pse jo t'u japim zgjidhje edhe të gjitha situatave për të cilat kemi nevojë, qoftë edhe me dialog.

Të nderuar kolegë dhe miq që ju kam përballë, sigurisht ju keni edhe numrat dhe mund ta bëni kauzën si të doni, por mendoj se në një demokraci të vërtetë nuk flet vetëm numri, por edhe argumenti, edhe profesionalizmi, pse jo edhe ta dëgjojmë njëri-tjetrin. Nuk duhet të kemi frikë që atje, ku ka probleme, të themi që ky problem ekziston dhe duhet zgjidhur. Nëse nuk e zgjidhim dot këtë problem, atëherë hajdeni t'i japim zgjidhje, ose ta lëmë për t'i dhënë zgjidhje më vonë, po nuk kemi pse të shqetësohemi kur opozita ka kauzë zgjidhjen e problemit dhe bëhet pjesë e zgjidhjes së tij. Prandaj, do t'ju këshilloj që në komunikim me njëri-tjetrin të kemi kujdes dhe të ruajmë etikën.

Do të sugjeroj që në kalendarin e sotëm të shtojmë edhe seancë dëgjese me dy ministret, atë të Arsimit dhe të Shëndetësisë, në raport me nevojat që kanë dhe masat që janë marrë për parandalimin dhe luftën kundër drogës, sidomos në shkolla, pra si është gjendja reale, çfarë parashikohet sot, cili është legjislacioni dhe çfarë ndihme do të jepet. Mendoj që në diskutimin që bëjmë së bashku duhet të kuptojmë që, nëse flasim për të drejtat e njeriut dhe nëse flasim në emër të të drejtave të njeriut, duhet të marrim ato përgjegjësi që kemi pa pasur frikë dhe pa u përballur me situatat ku jemi.

Faleminderit!

**Petrit Vasili** – Po, zonja Spiropali.

**Elisa Spiropali** – Në datën 20 ishte Dita Ndërkombëtare e Jetimëve dhe në bëmë një dëgjese me shoqatat e tyre në parlament. Ata kanë disa propozime për statusin e jetimit, që mua mu duken me vend, propozime për përmirësim të ligjit. Mendoj se është e domosdoshme që në këtë komision ta përfshijmë me rastin e 1 qershorit ose mund të lëmë një seancë tjetër pak më vonë, në mënyrë që ata të vijnë dhe të prezantojnë propozimet që kanë dhe ne të ngremë një grup pune. Di që edhe zonja Hysi te Komisioni i Ligjeve do të bëjë të njëjtën gjë, ndoshta mund të bëjmë një grup pune të përbashkët, por seancën e parë ta bëjmë këtu në Komisionin e Çështjeve Sociale dhe të dalim me një konkluzion dhe me propozime konkrete për ndryshimin e statusit të jetimëve dhe përmirësimin e ligjit.

Nuk e di a është e mundur ta përfshijmë në këtë kalendar apo mund ta lëmë për radhës tjetër, meqë ishte ditë ndërkombëtare!

**Petrit Vasili** – Në kalendarin që kemi para janë të gjitha mundësitë për të reflektuar dhe mendoj që vënia e tyre në të njëjtën ditë me 1 qershorin do ta sfumonte. Ky është mendim krejt personal, nuk e imponoj, por nëse kemi dakordësinë, unë mendoj që në vijim të kësaj ideje të bëjmë një dëgjese vetëm me ta, pasi do të shërbente si shtysë që të marrim përsipër rishikimin e problemeve të tyre. Në rast se mund ta fusim në kalendar, mirë, në rast se jo, ta planifikojmë në datën më të parë të kalendarit të ardhshëm.

Ndërkohë, nëse biem dakord, ne e pranojmë në parim këtë gjë dhe sekretaria të shohë mundësinë për ta futur në kalendar në ditët që janë në dispozicion. Ky kalendar ka ndjekur një logjikë të caktuar, që dy seanca i konsumon me projektligjin në parim dhe në tërësi, kurse ditët e tjera nuk diskutohen. Në rast se do të mund ta fusim brenda këtyre 3 javëve, pse jo, në rast se jo, atëherë e vëmë në fillim të kalendarit 3-javor dhe u themi shoqatave që të paraqesin paraprakisht një material për ta shpërndarë, me qëllim që secili të ketë një material përmbledhës ditën e dëgjesës, në mënyrë që debati të jetë sa më interaktiv.

**Floida Kërpaçi** – Zoti kryetar, kam vetëm diçka. Unë i propozova edhe herën e kaluar komisionit për një dëgjese me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit për sa u përket çështjeve të rinisë, të vijmë që të raportojmë se ku janë me planin kombëtar të veprimtari. Ka disa problematika që duhet t'i shohim. Duke parë sfidat dhe problemet që të rinjtë kanë sot, gjykoj që largimet masive të tyre duhen vendosur në një plan shumë të shkurtër të komisionit për ta zhvilluar këtë dëgjese.

Faleminderit!

**Petrit Vasili** – Tani, besoj se e njëjta logjikë do të veprojë për të dyja çështjet dhe nuk më duket se ka ndonjë hapësirë shumë të madhe kalendari i deritanishëm, duke pasur parasysh edhe ditët e punës. Megjithatë unë, me mirëkuptimin tuaj, do të flas me sekretarinë se mos gjejmë ndonjë hapësirë qoftë për jetimet, qoftë për këtë, me qëllim që t'i shterojmë. Nuk besoj se mund t'i shterojmë të dyja bashkë me këtë 3-javësh që kemi. Propozimi i zonjës Kërpaçi është që, nëse duhet ndonjë informacion paraprak nga ministria, komisioni të mund t'i drejtohet ministrisë për ta pasur parasysh të gjithë kolegët. Kështu që biem dakord në parim që të dyja duhet të jenë pjesë e punës dhe çfarëdo që të përfshijmë brenda kalendarit do ta komunikojmë menjëherë brenda ditës së sotme ose të nesërme. Për çfarë është e pamundur të futet, do të biem dakord që do të jetë patjetër pjesë integrale e kalendarit të tri javëve të tjera.

A ka ndonjë çështje tjetër për të shtuar në lidhje me këtë? Nuk ka.

Jemi të gjithë dakord.

Faleminderit!

Këtu mbyllim mbledhjen.

Ditën e mirë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**